



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4876 Prot.

Roskovec, më 01, 07 2024

V E N D I M

Nr. 34, datë 28 / 06 /2024

“PËR MIRATIM FONDE SHITESË NË BUXHETIN E BASHKISË ROSKOVEC PËR VITIN 2024”

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 1.2 gërma b, neni 23 dhe neni 54 pika dh, të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjen vendore” neni 45, të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH" i ndryshuar neni 44, paragrafi II, gërma a, të udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, të VKB nr.109 datë 21.12.2023 “Për miratimin e buxhetit, numrin maksimal të punonjësve të Bashkisë Roskovec dhe ndërmarjeve vartëse për vitin 2024”, si dhe materialeve të sjellë nga Sektori i Qendrave Social-Komunitare të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë,

-VENDOSI :

- I. Të miratohet fondi shtesë i të ardhurave për vitin 2024 prej **2,999,000 lekë** nga “Dhurata dhe sponsorizime të ndryshme” financim i Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, financim për programin Askush të mos ngelet pas, LNB2.
- II. Të miratohet përdorimin e fondit të mësipërm për shpenzimet sipas relacionit të bashkëlidhur, si më poshtë vijonë :

Shtohet:

- NJËSIA SHPENZUESE “BASHKIA ROSKOVEC”, KODI 2113001

Gr.00 TIT. 10430 KAP. 05 ART. 602 **2,999,000 lekë**

III. Ngarkohet Administrata e Bashkisë dhe Drejtoria Ekonomike për zbatimin e këtij vendimi.

IV. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R
Afrim Plaka

